

STATUSI
DHE
AKTI I THEMELIMIT
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"TAF AJ 2024" Sh.p.k.

Shtetasi Ram Tafaj , i lindur me 02.12.1981 , ne Tropojë identifikuar me ane te Kartes se identitetit I11202050Q, madhor me zotesi te plote per te vepruar, nen cilësinë e ortakut themelues.

Krijojë sotë me datën 01.06.2024 Shoqërinë me përgjegjësi te kufizuar "TAF AJ 2024" Sh.p.k. me seli ne Lagjen Valis, Vila 22 Njesia Administrative Kashare Tirane. Statuti është akti baze ku do te mbështetet themelimi i shoqërisë tregtare "TAF AJ 2024" Sh.p.k, si dhe zhvillimi i mëtejshëm i saj.

NENI 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

1.1 Ortaku i kesaj shoqërie Z. Ram Tafaj eshte zoteruesi 100 % te kapitalit te shoqërise. Ne perqindje e aksjoneve si me poshte:

1. Ram Tafaj do te zoterojne 100% te aksjoneve.

NENI 2

EMERTIMI I SHOQERISE

2.1. Shoqëria mban emrin "TAF AJ 2024" Sh.p.k dhe eshte person Juridik Shqiptar.

2.2. Kjo shoqëri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit.

2.3. Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontratat respektive.

NENI 3

SELIA E SHOQERISE

3.1. Shoqëria "TAF AJ 2024" Sh.p.k, me seli ne Lagjen Valis Vila 22 Njesia Administrative Kashare Tirane



NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

4.1. Objekti i Veprimtares Shoqërisë është :

Hoteleri (Akomoduese),Restorant, Sherbime bar - bufe, e tjera ne fushen e Turizmit, eksport te produkteve ushqimore, orendive shtepiake dhe tregtimin e tyre me shumice e pakice etj.

4.2. Aktivitetet e sipërpërmendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konformë me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortaku i saj.

4.3. Shoqëria mund te zgjeroje, ndryshojne ose kufizojë fushën e veprimtarisë se saj ne çdo kohe, kjo e bazuar ne vendimin e asamblese se ortakve te shoqerise "TAF AJ 2024" Sh.p.k.

NENI 5

PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM

5.1. Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise e ortakut te shoqerise "TAF AJ 2024" Sh.p.k

5.2. Ortaket e shoqeris, nuk jane pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, pertej kapitalit themeltar te saj, qe vete kane nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te ortakve te shoqerise .

NENI 6

KOHEZGJATJA

6.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj.

NENI 7

SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "TAF AJ 2024" Sh.p.k

KREU II

NENI 8

KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "TAF AJ 2024" Sh.p.k. eshte 100.000 leke e cili perbehet nga:

8.1. Kapitali para me vlere te barabarte me 100.000 (nje qindemije) leke

8.2. Shoqeria "TAFAJ 2024" Sh.p.k perbehen nga 1(nje) kuotë, me vlere nominale 1 (nje) kote eshte barabarte me 100.000 (njeqindemije) leke.

8.3. Ortaket zoterues 100% te aksjoneve eshte Z. Ram Tafaj qe pergjigjet per humbjet e shoqërisë perkundrejt te treteve deri ne vlerën e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqërisë.

NENI 9

TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku ne favor te treteve, kryhet gjithnje me akt noterial te posaçem.

9.2. Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 100.000 (nje qindmije) leke. Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakve te shoqërisë dhe sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqërite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqërisë mund te zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne shërbime, nëpërmjet emërimit te një eksperti te autorizuar për këto kontribute.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakeut te shoqërisë në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

9.5. Vendmi per zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

NENI 10

TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

10.2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

10.3. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit t". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

NENI 11

ORGANI VENDIMARRËS

11.1. Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

11.2. Ortaket, vendosin për çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve;
- g) ndryshimin e statutit, e selisë së shoqërisë, hapjen dhe mbylljen e filialeve të saj.
- h) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaket e shoqërisë duhet të regjistrohen në regjistrin e vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundërshtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 12

ADMINISTRATORI

12.1. Administratori i shoqërisë mund te caktohet edhe një person tjetër, jashtë orokëve.

12.2. Administrator i shoqërisë u vendos Z. Ram Tafaj me k. Idetiteti I11202050Q.

12.3. Administratori i shoqërisë do te ushtroje kompetencat e administrimit për një afat 4 vjeçar duke nisur nga data e themelimit 01.06..2024 e ne vazhdim, me te drejte ripërtëritje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare". Administratori munde te zvedesohet edhe pa mbaruar mandatin, ne nqs doheqje apo per arsye te ndryshme me vendim te asamblese se ortakve, per largimin dhe emerimin e administratorit te shoqerise.

NENI 13

KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe te jashtëzakonshëm te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ai vete.

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatitjen dhe te nënshkruajë bilancin vjetor, raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakve te shoqërisë ne mbledhjen e asamblesë se ortakeve.

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

13.2 Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

13.3 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

13.4. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përrjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombëtare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 15

BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë se Përgjithshme, e përberë nga Ortaket miratojnë bilancin e paraqitur nga Administratori.

15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e përberë nga Ortaket vendosin rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te mëparshëm financiar nqs ka, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

MBARIMI I SHOQERISE

16.1. Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Ortakeve ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) Me vendim të gjykatës;

16.2. Ne ketë rast, Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese " Shoqëri ne likuidim e sipër ".

16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë pagues, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse Ortaket e shoqërisë nuk merrini një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës,

për të caktuar një likuidues.

NENI 17

TRANSFORMIMI I SHOQERISE

17.1. Transformimi i shoqërisë behet me vendim të Ortakeve ose kur ekzistojnë faktorë të jashtëm detyrues ligjore, në këto raste vendimi merret pasi i është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këtë nen është i pavlefshëm.

NENI 18

BAZA LIGJORE

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

18.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të dale në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

NENI 19

MOSMARRREVESHJET

19.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirëkuptim.

19.2. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

NENI 20

DISPOZITA PER Fundimtare

20.1. Ky statut është hartuar me vullnetin e lire dhe të plote të Ortakëve të shoqërisë dhe është nënshkruar prej tyre.

20.2. Ky Statut u redaktua në katër kopje, në gjuhën shqipe. Një kopje mbahet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Ortakët Themelues "TAFAJ 2024" Sh.p.k

Ram Tafaj
Rafiq

Tiranë më 01.06.2024